




PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2026

PROFILI “GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI”





TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, TË METODOLOGJISË DHE TË PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	10
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	11
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	11



HYRJE

Ky program orientues është hartuar nga një grup pune i ngritur në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe synon që t’u vijë në ndihmë të gjithë kandidatëve, të cilët duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Programi përfaqëson dhe përmbush kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar duke iu përmbajtur kërkesave që MA-ja ka vendosur për kandidatët që do të testohen. Fushat kryesore, në të cilat do të testohen njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e kandidatëve janë:

- Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore-edukative të mësuesve.
- Programe lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për arsimin bazë dhe për arsimin e mesëm.
- Aspekte të pedagogjisë, të metodologjisë dhe të përdorimit të TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore e lëndëve “Gjuhë shqipe” në arsimin e mesëm të ulët dhe “Gjuhë shqipe dhe letërsi” në arsimin e mesëm të lartë.

¹ Është fjala për të gjithadokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MA-së që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të profilit “Gjuhë shqipe dhe letërsi” është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të të kandidatëve për mësues.

Programi ka për qëllim:

- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformave arsimore;
- zhvillimin e aftësive profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor;
- përmirësimin e aftësive në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve në organizimin e klasës, përzgjedhjen e metodave dhe teknikave mësimore, shtjellimin e koncepteve, nxitjen e diskutimeve në grup, përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe të ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me korrektesë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të profilit “Gjuhë shqipe dhe letërsi” është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe **rezultatet** që priten të zotërojnë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, si dhe **literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe për çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca	
“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - njeh dhe analizon ligjin për sistemin arsimor parauniversitar; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në

udhëzimeve të MA-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.	institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	---

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - njeh dhe analizon programin lëndor me të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me nxënësit, veçoritë e klasës dhe të shkollës në të cilin jep mësim; - harton plane mësimore duke respektuar kërkesat e programit lëndor; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e njohurive dhe të aftësive të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit; - analizon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe	- Korniza Kurrikulare 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, klasat VI-IX. - Programet e gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të letërsisë me zgjedhje, në arsimin e mesëm të lartë, klasat X -XII.

përshtatshmëria e programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë); - shpjegon lidhjen program-tekst nxënësi; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave kyç dhe lëndore; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjuhës shqipe dhe të letërsisë me fushat dhe me shkencat e tjera, si dhe me jetën reale.	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, TË METODOLOGJISË DHE TË PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE

Kompetenca I	
“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjëshmëri për profesionin e tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin njohës, fizik, social dhe emocional të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - njeh dhe analizon teknika të ndryshme të menaxhimit të klasës; - identifikon nxënësit me nevoja të veçanta	- Korniza e vlerësimit të nxënësit, 2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. - Udhëzuesi për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, 2018. - Udhëzuesi kurrikular për lëndën e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor për gjuhën shqipe dhe letërsinë (material ndihmës

(nxënësit me aftësi të kufizuar, nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; - edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkshërinë ndaj letërsisë dhe gjuhës shqipe; - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin, një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë), 2018.
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënësit; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin kritik e krijues të nxënësve; - planifikon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër	- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), 2016. - Udhëzuesi për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA, 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm

nxënësin; - përdor metoda e teknika që ndikojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore; - njeh dhe zbaton gjatë procesit të të nxënit lloje të ndryshme të vlerësimit; - vlerëson nxënësit duke u bazuar në nivelet e arritjeve; - përdor teknika dhe evidenca të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - ndërton një test duke zbatuar parimet e hartimit dhe të pikëzimit të një testi.	të lartë (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), 2019. - Udhëzuesi kurrikular për lëndën e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, 2018. - Udhëzuesi kurrikular lëndor për gjuhën shqipe dhe letërsinë (material ndihmës për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë), 2018. - Modele testesh për arsimin parauniversitar (<i>Teste të hartuara nga mësuesit</i>), profili “Gjuhë shqipe dhe letërsi”. - Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, ASCAP 2021.
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - prezanton materiale mësimore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Excel, Word; - udhëzon nxënësit që të bëjnë prezantime gjatë orës së mësimi duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;	- Urdhri, nr. 84 datë 06.05.2021 “Për miratimin e standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit”. - Materiali ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021

- gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare lëndore apo në projekte kurrikulare të integruara, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga Website të ndryshme.	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij, brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46, datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive të ndryshme në institucionin arsimor.	- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë”	
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - analizon dhe jep gjykimet e tij për letërsinë shqipe e botërore, për periudhat dhe drejtimit letrare, si dhe për shkrimtarët përfaqësues dhe krijimtarinë e tyre letrare; - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste e fragmente të ndryshme letrare dhe jo letrare;	- Tekste të gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të letërsisë me zgjedhje, për nxënësin dhe për mësuesin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen lëndore për klasat 6-9 për arsimin e mesëm të ulët, si dhe për klasat 10 - 12 për arsimin e mesëm të lartë.

- analizon dhe vlerëson tiparet e stilit dhe të gjuhës në një tekst ose fragment; - kryen analiza të sakta nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes; - respekton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit; - mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të gjuhës dhe të letërsisë në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.	
--	--

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al